



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:180216

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485425

Ac.nr.2181/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses B. K. e S. me seli në P., të cilën me autorizim e përfaqëson O. Q., kundër të paditurit H. (M.) I. nga fshati B. i Z, Komuna e L., të cilin e përfaqëson me autorizim N. Mj. avokat në P. rr xxxx, për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 87.300.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësja, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 248/15 të datës 01.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e paditëses B. K. e S. me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.248/15 i datës 01.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm me aktvendimin C.nr.248/15 të datës 01.06.2021, ka vendosur si në vijim:

I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses B. K. e S.me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri H. I. nga fshati Br. i Zi Komuna e L., që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut te datës 27.05.2008 në Lipjan, t’ia kompensoj shumën prej 87.300.00 euro me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet e procedurës, si e **PA BAZUAR**.

II.DETYROHET paditësja që në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 540.80 euro t'ia paguajë të paditurit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurë kontestimore, vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses apo që çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të ankesës së të paditurës së dytë, shqyrtimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditëses B. K. e S. me seli në Prishtinë është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, B. K. e S. me seli në P., përmes përfaqësueses së saj të autorizuar O. Q., me datë 26.06.2015, ka ushtruar padi për rimbursim dëmi kundër të paditurit H. I. nga fshati B. i Z Komuna e L. për rimbursim dëmi. Paditësja ka theksuar se ka zhduktuar, familjen I. të cilët ishin të dëmtuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 07.05.2018 me shumë prej 87.300.00 euro shumë kjo e cila u caktua në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan C.nr.244/08 të datës 16.06.2010. Sipas nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin nga Auto përgjegjësia numër 04/L-018 Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumë e paguar, shpenzimet dhe kamatat. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri, në përgjigje ne padi, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se padia është në kundërshtim me nenin 939 paragrafi 1, pika 4 të LMD-së (viti 1978) ku përjashtohet mundësia e paditëses që nga i padituri të kërkojë ri mbursimin e mjeteve financiare të paguara M., N. dhe Sh. I., pasi që i padituri është në afërsi familjare me të dëmtuarit në aksidentin e trafikut të datës 27.05.2008, prindër dhe vëlla, e me këtë nën parashihet se “ *Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtrave të të sigurvearit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të sigurvearin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi, apo i cili bashkëjeton me të në të njejtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të sigurvearit, përveç në qoftë se këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje*” Ka shtuar se i padituri me të dëmtuarit është në raport familjar , i biri i M. dhe N. dhe vëllai i tij Sh., andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoi në tërësi të pabazuar. Shpenzime e procedurës i ka kërkuar dhe atë për çdo seancë nga 270 euro.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seance gjyqësore dhe pas nxjerrjes dhe administrimit të provave ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me datën 27.05.2008 në rrugën nga Lipjani në drejtim të fshatit Bregu i Zi, afër udhëkryqit Magurë-Shtime-Lipjan, është shkaktuar aksident i komunikacionit në mes të automjetit “Opel Astra” me targa xxxxx të cilin e drejtonte H. (M.) I. (pa patent shofer) i lindur me datë 08.10.1992 dhe automjetit “Kombi Iveco” me targa xxxx të cilin e drejtonte I. H., e në të cili aksident kanë pësuar lëndime trupore pasagjerët e automjetit O.P , M., N. dhe Sh. I.. Padiësja iu ka kompensuar dëmin material dhe jo material të dëmtuarve M., N. dhe Sh. I. nga fshati Bregu i Zi Komuna e L., bazuar në Aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.224/08 të datës 16.06.2010, të plotfuqishëm me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2063/12 të datës 03.02.2015. Shuma, të cilën padiësja i ka kompensuar të dëmtuarit arrin vlerën prej 87.300 euro. Nga urdhri për përmbaram P.nr.470/14 i dt.03.04.2014, vërtetohet se përmbaruesi privat A. M., ka lëshuar urdhër për caktimin e përmbaramit në B. E. në P. , në bazë të të cilit urdhër nga xhirollogaria e debitorit B. K. e S. do të transferohet shuma prej 27.300 euro në xhirollogarinë e kreditorëve M. I., N. I. dhe Sh. I. në emër të borxhit për kompensimin e dëmit. Nga transferi bankar i datës 07.04.2015, vërtetohet se përmes përmbaruesit privat Afet Mjeku, bazuar në aktvendimin për përmbaram P.nr.480/14, është transferuar tek të dëmtuarit shuma prej 87.300 euro. Në bazë të nenit 939 paragrafi 4 të LMD-së së ish Jugosllavisë parashihet se *“përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të sigurvearit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të sigurvearin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të sigurvearit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje, pra nga ky përjashtim i të drejtës së subrogimit janë përfshirë personat e afërt të të sigurvearit, ndaj këtyre personave siguruesi përjashtimisht nuk fiton me subrogim të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit, e po ashtu është nuk është vërtetuar se i padituri e ka shkaktuar dëmin me dashje (qëllim), pasi që në kohën e kryerjes së veprës penale i padituri ka qenë i moshës së mitur (16 vjeç), dhe vepra penale rrezikim i trafiku publik është vepër që kruhet nga pakujdesia, andaj bazuar në dispozitat e LMD-së, gjykata gjeti se kërkesa e padiësës për rimbursim dëmi është e pabazuar. Për sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendimin e mori bazuar në nenin 449 paragrafi 1 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së.*

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 182 paragrafi 2, pasi që dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me

dispozitën e nenit 160, paragrafi 3, 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në rastin konkret, e në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pa dyshim është vërtetuar fakti se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 27.05.2008 në rrugën Lipjan në drejtim të fshatit Bregu i Zi, afër udhëkryqit Magurë-Shtime-Lipjan. Shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit O. A. me targa xxxxx – H. (M.) I. i lindur me datë 08.10.1992 (mosha 16 vjeçe) i cili ishte pa patent shofer. Ky i fundit kishte aksidentuar automjetin Kombi Iveco me targa xxxx të cilin e drejtonte I.H.. Në këtë aksident, lëndime trupore kishin pësuar pasagjerët e automjetit O. A , M., N. dhe Sh. I. e të cilit ishin në lidhje familjare me shkaktarin e aksidentit. B. K. e S. iu ka kompensuar dëmin material dhe jo material të dëmtuarve M., N. dhe Sh. I. sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.224/08 të datës 16.06.2010, të plotfuqishëm me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2063/12 të datës 03.02.2015 në shumën prej 87.300 euro. Në këtë drejtim, me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar se kërkesëpadia e paditëses është e pa themeltë e kjo për faktin se me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin. Mirëpo, sipas nenit 939 paragrafi 4 të LMD-së (viti 1978) përcaktohet se *“përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të siguruarit në siguruesin, këto të drejta nuk kalojnë në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të siguruarin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të siguruarit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje, andaj nga ky përjashtim i të drejtës së subrogimit janë përfshirë personat e afërt të të siguruarit, ndaj këtyre personave siguruesi përjashtimisht nuk fiton me subrogim të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit. Po ashtu nga shkesat e lëndës nuk vërtetohet se i padituri e ka shkaktuar dëmin me dashje (qëllim), dhe se shkaktuesi i dëmit me të dëmtuarit është në lidhje të ngushtë familjare, përkatësisht të njëjtit i ka prindër dhe vëllezër dhe jetonin në një bashkësi familjare, e gjithashtu, sa i përket kryerjes së veprës penale, nga shkresat e lëndës konstatohet se shkaktuesi i aksidentit- i padituri H. I. në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së mitur (16 vjeç), dhe vepra penale rrezikim i trafiku publik është vepër që kryhet nga pakujdesia, andaj në rastin konkret në këtë grup të veprave penale gjithnjë mundon elementi volutiv-dashja e kryesit në kryerjen e veprës penale dhe shkaktimin e pasojave. Andaj, pretendimet e paditëses mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk*

qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktgjykimit, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pa themelësinë kërkesëpadisë së paditëses është i drejtë dhe i argumentuar.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pa themelësi e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditëses në rastin konkret është e pathemeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditëses në rastin konkret është e pabazuar.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit 452 par.1 të LPK-së, dhe se i padituri me dokumentimin e shpenzimeve procedurale në lartësinë si në pikën **II** të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, të njëjtit i takon e drejta e pagesës së këtyre shpenzimeve nga paditësja.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Gjykata e Apelit i analizoi dhe mori për bazë edhe pretendimet e tjera ankimore të palëve ankuese por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 2181/22, data 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka